



K.DH.SH.II.nr.1335/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “Ana Petrol” me seli në fsh. Lluzhan, Komuna Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ali Ajeti, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit të parë Kompania e Ujësjetësit “Prishtina”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.M. dhe të paditurit të dytë Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.H., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.127/22 të datës 24.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit NTP “Ana Petrol” me seli në fsh. Lluzhan, Komuna Podujevë, e datës 18.09.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.127/22 të datës 24.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin KA.nr.127/22 të datës 24.05.2023, nën pikën I. të dispozitivit, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit NTP “Ana Petrol” me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit nr.173/19 të datës 10.07.2019 i nxjerrë nga i padituri Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit si dhe të obligohet i padituri Kompania Rajonale e Ujësjetësit

“Prishtina” që paditësit t’ia kthej shumën prej 901.42€. Nën pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi KA.nr.127/22 datës 24.05.2023 të ndryshohet ose që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar të paditurës Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Prishtina” nr.195975/19 të datës 08.05.2019 është refuzuar ankesa e konsumatorit me nr. referent 195975 e datës 25.02.2019 lidhur me rishqyrtimin e ankesës për kontestimin e faturimit si e pa bazuar.

Ndërsa me vendimin e kontestuar të paditurës Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit, nr. 173/19 të datës 10.07.2019, nën pikën I. të dispozitivit është refuzuar ankesa Ali Ajeti “Ana Petroll” me nr.427/DL datë 25.06.2019 lidhur me kontestimin e faturimit si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi me nr.195975/19 i datës 08.05.2019. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, është vendosur që ky vendim hynë në fuqi ditën e nxjerrjes.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.08.2019, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të kontestuar të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me arsyetim se Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e konsumatorit dhe ka vërtetuar vendimin e KRU Prishtina pasi që nga vlerësimi i të gjitha provave rezulton se faturimi i bërë nga i padituri i parë ka qenë i rregullt dhe se për shkak se i padituri nuk ka dërguar ujëmatësin për kalibrim ka qenë e pamundur konstatimi i gjendjes faktike apo vërtetimi i pretendimeve të paditësit për gabimet e mundshme në matje të shpenzimeve. Nga prova Kodi i matësit e dorëzuar përmes parashtrësës së datës 02.05.2023 gjykata ka konstatuar se paditësi është faturuar përmes të dhënave të dërguara me pajisje elektronike dhe se është faturuar së paku një herë në muaj dhe se gjatë 3 muajve të parë, paditësi ka pasur ujëmatësin me nr. U14-043553, ndërsa pas kësaj sipas kartelës së matësit është ndërruar ujëmatësi paraprak dhe është vendosur ujëmatësi U14-046595 (nr. serik: 3784933). Gjykata konstatoi se ndërrimi i ujëmatësit pa autorizimin e KRU Prishtina është në kundërshtim me nenin 27 par.1 të Rregullores nr.02/2016 i cili përcakton se “ujëmatësit duhet të instalohen, zëvendësohen apo zhvendosen vetëm nga punëtorët e autorizuar të Ofruesit të shërbimeve apo nga ndonjë person tjetër nën mbikëqyrjen e Ofruesit të shërbimeve”, andaj pamundësia e verifikimit të saktësisë së matjes së ujëmatësit sipas ankesës së paditësit, në këtë rast nuk bie në përgjegjësinë e KRU Prishtina pasi që vet paditësi nuk e ka dorëzuar ujëmatësin për verifikim. Prandaj gjykata vlerëson se ARRU ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzoj ankesën e konsumatorit dhe të vërtetoj vendimin nr.195975/19 të datës 08.05.2019, pasi që paditësi nuk arriti të provojë gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar me procedurë administrative. Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në këtë çështje, përkatësisht fotografitë e ujëmatësit të dorëzuara nga paditësi dhe të paditurit por nga të njëjtat nuk arriti të konstatojë kohën se kur janë bërë fotografitë dhe numrin e ujëmatësit të fotografuar, andaj të njëjtat nuk i mori parasysh gjatë vlerësimit të provave. Prandaj gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative i padituri ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, kur ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar. Mbi këto arsye, gjykata nuk i aprovoi thëniet e paditësit në padi, sepse i vlerësoi si pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë do të duhej të vërtetonte faktin se a ka pasur faturim të pa bazë ndaj subjektit ekonomik Ana Petroll në muajin nëntor 2017 apo jo ngase ky do të ishte fakti i vetëm që do të duhej të vërtetohej nga gjykata meqë paditësi pretendon se është ngarkuar në mënyrë të kundërligjshme nga KRU Prishtina në shumë prej 897.09€. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerr prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e të paditurës, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, ku nga prova kartela financiare e paditësit për periudhën 30.09.2017 e deri më 28.02.2019 shihet se faturimi nga ana e të paditurës ndaj paditësit ka filluar me datë 30.09.2017, ndërsa faturimi për shpenzimet e paditësit në shumën prej 897.09€ është bërë me datë 30.11.2017. Prandaj, meqë konsumatori në fjalë është faturuar sipas ujëmatësve të instaluar, dhe faturimi është bërë në përputhje me nenin 32 par. 1.2 dhe 4 i rregullores nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë. Andaj, kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i lartcekur i të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka aplikuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, ka anashkaluar në tërësi dispozitat e së drejtës materiale dhe parimet e drejtësisë që lidhen me çështjen për të cilën është iniciuar padia dhe i njëjti edhe pse përmban referenca ligjore këto referenca ligjore janë në kundërshtim me gjendjen faktike e cila është vërtetuar edhe nga gjykata gjatë procedurës, ky kolegji nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Po ashtu sa i përket pretendimeve ankimore, se ujëmatësi është ndruar nga puntorët e kompanisë së ujësjedhësit me datën 31.01.2019 kolegji vlerësoj se një pretendim i till nuk është e bazuar në provat e paraqitura nga paditësi në gjykatën e shkallës së parë pasi që procesverbali për kontroll dhe inspektim i datën 31.01.2019 të paditurës KRU Prishtina rezulton se konsumatori ka ujëmatës me gjendje të shpenzimit 312 m³, pra paditësi nuk ka argumentuar se puntorët e ujësjellësit ka bërë ndrimin e ujëmatësit. Andaj, duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1335/23, me datë 16.04.2024.

Kryetar i kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri